



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**



**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**  
**Telecommunications Regulatory Authority**  
**Regulativni Autoritet Telekomunikacije**

**Nr.Prot. 041/B/11**

**Draft Rregullore**

**për**

**të dhënat statistikore periodike të ndërmarrjeve për operimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve telekomunikuese dhe operatorëve postar**

Kjo rregullore është nxjerr në bazë të nenit 1, pika (2); nenit 4, pika (4); nenit 12 pikat (1), (2), dhe (3) të Ligjit të Telekomunikacionit Nr. 2002/7, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-085 (tutje i njohur si - Ligji); nenit 6. 1.13 i Ligjit për Shërbimet Postare; pika 2.1 e dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të datës 13/06/2007, i protokolluar pranë ART-së me Nr. Prot. 195/07, Vendimit Nr. 12, Ref. Nr. Prot. 25/1/10 të datës; 16/03/2010.

**Neni 1**

**Fushëveprimi dhe Qëllimi i kësaj Rregulloreje**

- 1.1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i dorëzimit të të dhënave periodike për shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit, të ofruara nga ndërmarrjet e licencuara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (tutje i njohur si ART) dhe nga operatorët postar, përfshirë edhe detyrimet dhe afateve kohore për dërgimin e të dhënave.
- 1.2. Kjo rregullore zbatohet ndaj të gjitha ndërmarrjeve, të cilat ofrojnë shërbime telekomunikuese dhe operatoreve postar, të cilët janë të licencuar nga ART dhe bëjnë pjesë në regjistrin e ndërmarrjeve të publikuar në faqen zyrtare të ART-së.
- 1.3. Kjo rregullore i merr parasysh praktikat më të mira të shteteve evropiane dhe më gjerë, në atë masë sa janë në pajtueshmëri me Ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

**Neni 2**

**Definicionet**

Për qëllim të kësaj rregulloreje:

- 2.1. Kuptimi ose definicioni i cilësdo fjalë, frazë apo shprehje në bazë të Ligjit, do të jetë gjithashtu i zbatueshëm për atë fjalë, frazë apo shprehje në këtë rregullore,
- 2.2. Termat dhe shprehjet që pasojnë do të kenë këtë kuptim:

Faqe 1 nga 5

**Pyetësor:** është një formular i veçantë i përbërë nga një numër i caktuar pyetjesh që ka për qëllim mbledhjen e të dhënave, analizën e tyre dhe publikimin në mënyrë periodike;

**Ndërmarrje:** është një kompani e autorizuar ose licencuar për të ofruar shërbime telekomunikuese në territorin e Republikës së Kosovës;

**Operator Postar:** mund të jetë:

**Operator publik postar;** person juridik i licencuar për ofrimin e shërbimeve universale postare;

**Operator i shërbimit postar;** person juridik i licencuar për ofrimin e shërbimeve postare.

### **Neni 3**

#### **Detyrimet e ndërmarrjeve për dërgimin e të dhënave**

- 3.1. Çdo ndërmarrje/operator e/i specifikuar në nenin 1.2 të kësaj rregulloreje, është e obliguar që të plotësojë pyetësorët e listuar në nenet 4.1.1 dhe 4.2.1 (në vijim), duke dërguar dhe plotësuar informacionin e kërkuar sipas procedurave dhe afateve të parapara me këtë rregullore.
- 3.2. Është përgjegjësi e plotë vetanake e çdo ndërmarrje që të shkarkojë, plotësojë dhe dorëzojë pyetësorët konform afateve kohore të specifikuara në këtë rregullore.
- 3.3. Në rast se ART kërkon të dhëna tjera, të cilat nuk janë të specifikuara në pyetësorë, atëherë ndërmarrjet/operatorët postar obligohen që të dërgojnë këto të dhëna sipas mënyrës që ART vlerëson se është e nevojshme dhe arsyeshme.
- 3.4. Me qëllim të sqarimit, plotësimit të të dhënave, personat përgjegjës të ndërmarrjeve janë të obliguar që të marrin pjesë në takime sa herë që ART e sheh të arsyeshme dhe të nevojshme.

### **Neni 4**

#### **Pyetësorët**

- 4.1. Informacioni dhe të dhënat që duhet të dërgojnë ndërmarrjet e licencuara për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve telekomunikuese janë specifikuar në Pyetësorë, të cilët janë të publikuar në ueb faqen e internetit të ART-së <http://www.art-ks.org> në seksionin "Tregu".
  - 4.1.1 Pyetësorët përfshijnë shërbimet si në vijim:
    - a) Pyetësori për ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të internetit;
    - b) Pyetësori për ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të telefonisë mobile;
    - c) Pyetësori për ofruesit e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të telefonisë fikse;
    - d) Pyetësori për ofruesit e shërbimeve të linjave me qira.

- 4.2. Informacioni dhe të dhënat që duhet të dërgojnë operatorët postar janë specifikuar në Pyetësorë, të cilët janë të publikuar në ueb faqen e internetit të ART-së <http://www.art-ks.org> në seksionin 'Shërbimet Postare'.
- 4.2.1 Pyetësorët për operatorët postar përfshijnë:
- Pyetësori për operatorin publik postar;
  - Pyetësori për operatorët tjerë postar.
- 4.3. Ndërmarrjet/operatorët postar janë të obliguara që të plotësojnë pyetësorët varësisht nga shërbimet që ofronjnë apo përfitojnë nga operatorët tjerë, sipas shpjegimeve të dhëna në pyetësorët respektiv.

## Neni 5

### Mënyra e dërgimit si dhe afatet e plotësimit të pyetësorëve

- 5.1. Të dhënat e kërkuara sipas pyetësorëve të specifikuar në nenet 4.1.1 dhe 4.21 të kësaj rregulloreje, duhet të dërgohen në ART çdo tre muaj, dhe atë jo më vonë se 15 ditë pas përfundimit të tremujorit.
- 5.2. Të dhënat e dërguara nga ndërmarrjet/operatorët postar duhet t'i përkasin tremujorit për të cilin bëhet raportimi.
- 5.3. Pyetësorët e plotësuar nga ndërmarrjet/operatorët postar dërgohen në ART si në vijim:
- Një shkresë shoqëruese e firmosur dhe e vulosur nga personi i autorizuar i ndërmarrjes/operatorit postar;
  - Secili Pyetësor duhet të jetë i plotësuar dhe i printuar (i njëjtë me atë të formës elektronike), i cili është i vulosur dhe i mbyllur në një zarf të veçantë me shënimin 'Pyetësori/ët për të dhënat statistikore';
  - Pyetësorët e plotësuar në formatin elektronik, gjegjësisht Microsoft Excel në CD.

## Neni 6

### Verifikimi i të dhënave nga ART

- 6.1. Nëse të dhënat e dërguara nga ndërmarrja/operatori postar nuk janë në standardin e të dhënave të kërkuara nga ART dhe krijojnë dyshime mbi saktësinë e tyre, atëherë:
- ART mund të kërkojë sqarime ndërmarrjes/operatorit postar ose personit të autorizuar përmes telefonit, apo përmes shkresës, e cila mund të jetë në format elektronik (e-mail) apo të shtypur;
  - Personi i autorizuar duhet të jap sqarime dhe informacion të saktë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në pyetësorët e të dhënave, jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës nga ART të cituar në nenin 6.1.a) të kësaj rregulloreje;

- c) ART mund të kryej në çdo kohë verifikimin e saktësisë së të dhënave të depozituara nga ndërmarrja/operatori postar, nëpërmes inspektimit në ambientet e ndërmarrjes/operatori postar.

## **Neni 7**

### **Përdorimi i të dhënave nga ART**

- 7.1. ART do të bëjë përpunimin e të dhënave të dërguara nga ndërmarrja/operatori postar, të cilat do të shërbejnë si bazë për;
- a) Monitorimin e vazhdueshëm të zhvillimit të tregut të telekomunikacionit dhe tregut të shërbimeve postare në Republikën e Kosovës për verifikimin e plotësimit të objektivave rregullatore;
  - b) Zhvillimin e analizës së tregjeve nga ART;
  - c) Informacion për publikun nëpërmjet raporteve periodike në baza tremujore që evidentojnë treguesit kryesor të zhvillimit të tregut /tregjeve;
  - d) Plotësimin e kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që monitorojnë zhvillimin e tregut të telekomunikacionit dhe shërbimeve postare në Republikën e Kosovës.
- 7.2. ART zbaton parimet e konfidencialitetit në publikimin dhe përdorimin e të dhënave të tregut të telekomunikacionit në pajtueshmëri të plotë me Ligjin;

## **Neni 8**

### **Sanksionet**

- 8.1. Mos-dërgimi i pyetësorëve të plotësuar sipas afateve kohore dhe kërkesave të ART-së të përcaktuara në këtë rregullore, paraqet shkelje të nenit 12 të Ligjit.
- 8.2. Dorëzimi i të dhënave të pavërteta nga ana e ndërmarrjes do të ketë për pasojë shqiptimin e masave sanksionuese sipas Udhëzimit Administrativ Mbi Caktimin e Dënimeve për Kundërvajtje nga Telekomunikacioni, Nr. 2004/3.
- 8.3. Mos përmbushja e kërkesave të parapara me nenin 43 paragrafi (1) të Ligjit 03/L-173 përfshi këtu dorëzimin e të dhënave të pavërteta nga ana e operatoreve postar do të ketë për pasojë shqiptimin e masave sanksionuese si parapare me dispozitat e nenit 44 paragrafi 1 nënpika 1.1 të Ligjit 03/L-173.

## **Neni 9**

### **Dispozitat përfundimtare**

- 9.1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë çështje.

- 9.2. Ky akt do të jetë subjekt i çfarëdo apelimi nga palët e pakënaqura përmes procedurave administrative gjyqësorë, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 9.3. Operatori do të jetë përgjegjës për zbatimin e Rregullores sipas procedurës, të përshkruar nga aktet ligjore të Republikës së Kosovës.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria**

- 10.1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj me një vendim të Bordit të ART-së dhe mbetet në fuqi deri sa të nxirret një rregullore tjetër.

**Klasa: 01/11**  
**Reg. Nr: 11,**

**Prishtinë,**  
**19/07/2011**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetari i Bordit të ART-së**

---